



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 48 prot

Durrës, më 20.11 .2017

V E N D I M

Nr. 30, datë 20.11 2017.

P Ë R

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË STUDIMIT PËR STUDENTËT TË CILËT
JANË REGJISTRUAR PËR HERË TË PARË NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE
ME KOHË TË PLOTË PRANË UNIVERISTETIT "ALEKSANDËR MOISIU",
DURRËS, NË VITIN AKADEMIK 2017-2018**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 "Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë", pika 3, gërma ç "*autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës: për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj*", ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Udhëzimit të MAS nr. 15, datë 19.05.2017 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017 - 2018", i ndryshuar me udhëzimin nr. 18 datë 16.08.2017, Shkresës nr. 335/2/1 prot., datë 04.04.2017 me objekt "Kthim përgjigje, per kuotat dhe tarifat e propozuara per vitin akademik 2017-2018, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës", Vendimit nr.13 datë 25.05.20147 të Bordit të Administrimit "Për miratimin e tarifës së shkollimit, për studentët të cilët janë regjistruar për herë të parë në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në vitin akademik 2016 - 2017, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, në mbledhjen e datës 20.11.2017, Bordi i Administrimit i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të studimit, për studentët të cilët janë regjistruar për herë të parë, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në vitin akademik 2017-2018, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas tabelës nr. 1.1 bashkëlidhur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:



- Kancelari
- Drejtoria e Menaxhimit Financiar
- Dekani i Fakultetit të Biznesit
- Dekani i Fakultetit të Edukimit
- Dekani i Fakultetit të Studimeve Profesionale
- Dekani i Fakultetit të Shkencave Politike dhe Juridike
- Dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Alqi KUSHI



Tabela nr. 1.1

Tarifat vjetore të shkollimit për studentët të cilët janë regjistruar për herë të parë në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në vitin akademik 2017-2018 pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës

UNIVERSITETI	FAKULTETI	Tarifa vjetore (për 60 kredite) (në lekë)	Tarifa vjetore (për 60 kredite) program i dytë studimi (në lekë)
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	I BIZNESIT	26,000	86,400
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	I EDUKIMIT	26,000	135,000
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	I TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT	26,000	204,000
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	I SHKENCAVE POLITIKE DHE JURIDIKE	26,000	146,000
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	I STUDIMEVE PROFESIONALE (PROGRAM ME 120 KREDITE)	26,000	93,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	I STUDIMEVE PROFESIONALE (PROGRAM ME 180 KREDITE)	26,000	247,950

KRYETAR I BORDIT TE ADMINISTRIMIT

Alqi KUSHI